



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR  
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER  
ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER  
GJIMNAZI “PERIKLI IKONOMI” FIER

PLANI VJETOR  
PËR VITIN SHKOLLOR 2022-2023

## PROCEDURA E HARTIMIT TË PLANIT

---

Plani vjetor i gjimnazit “Perikli Ikonomi” Fier për vitin shkollor 2021-2022 hartohet mbështetur në:

- Rregulloren për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, nenet 51, 52 dhe 53;
- Udhëzimin e përbashkët të MAS dhe MFE nr. 22, datë 27.7.2022 “Për vitin shkollor 2022–2023 në sistemin arsimor parauniversitar”;
- Planin afatmesëm të shkollës 2022-2026.

Hartimi i këtij plani ka filluar me analizën e detajuar që drejtorja e shkollës u ka bërë rezultateve të arritura në përfundim të vitit shkollor në qershor 2022, të rezultateve të sesionit të parë të provimeve të Maturës Shtetërore të këtij viti dhe përpunimit të të dhënave për plotësimin e Kartës së Performancës së shkollës për vitin 2021-2022.

Në përfundim të vitit shkollor 2021-2022, në qershor 2022, nga drejtorja e shkollës u hartua edhe raporti vjetor, prej të cilit dalin edhe treguesit analitikë të paraqitur, si edhe konkluzionet mbi gjendjen e shkollës dhe realizimin e planit të atij viti.

Në fund të muajit gusht u ngrit edhe grupi i punës për formatimin e planit për vitin e ri shkollor 2022-2023, i kryesuar nga drejtorja e shkollës.

Në javën e parë të shtatorit plani i hartuar iu paraqit bordit të shkollës.

Plani vjetor i shkollës i paraqitet sipas grafikut Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Fier dhe zbatohet prej datës 12.9.2022.

## ANALIZA E GJENDJES

---

### 1. Ndjekja e IA-së (përqindja e braktisjes së shkollës, përqindja e mungesave vjetore e të gjithë nxënësve kundrejt të gjitha orëve mësimore).

Nga numri i nxënësve të regjistruar në shtator-tetor 2021 (531 nxënës), deri në fund të vitit shkollor ishin larguar gjithsej 62 nxënës ose përafërsisht 12% e kontingjentit. Kjo rezulton të jetë shifra më e lartë e disa viteve dhe rrezikoi edhe realizimin e planit afatmesëm 2018-2022 në vitin e fundit të tij, ku synimi ishte rritja sasiore e shkollës. Janë analizuar disa tregues dhe është arritur në përfundimet e mëposhtme. Në ndryshim nga dy vitet e mëparshme, kur për shkak të mbylljes së përgjithshme prej pandemisë u bë e pamundur apo u kufizua ndjeshëm lëvizja e njerëzve, gjatë vitit shkollor 2021-2022 pati një numër të konsiderueshëm largimesh të nxënësve për jashtë vendit. 37% e të gjithë të larguarve nga kontingjenti janë nxënësit që kanë emigruar jashtë vendit. Jo të gjithë kanë tërhequr dokument shpërnguljeje nga shkolla, por janë marrë deklarata prej të afërmeve për faktin e largimit të tyre jashtë shtetit. Numri i nxënësve të përjashtuar për arsye mungesash është 7 ose 11% e të gjitha largimeve, ndërsa 11 nxënës të tjerë (17%) janë larguar pa dhënë ndonjë arsye, jozyrtarisht vlerësojmë se edhe ky grup janë të larguar jashtë vendit. 35% e të larguarve janë transferuar në shkolla të tjera, 14 prej tyre nga 22 të transferuar kanë shkuar në institucione arsimore private të qytetit të Fierit (11 janë nga klasa XI). Vlerësojmë se lehtësitë që u ofrohen nga IA private për rezultate të larta janë arsye kryesore e këtyre transferimeve. Transferimet drejt shkollave private brenda qytetit janë mundësuar edhe nga miratimi i menjëhershëm i transferimeve prej ZVAP Fier. 6 nxënës janë transferuar në fund të periudhës së parë drejt gjimnazeve publike në ZVAP Fier.

Gjatë vitit shkollor 2021-2022 nxënësit për secilën klasë kanë munguar mesatarisht në 3,1% të orëve mësimore, duke mos arritur njërin nga objektivat e përcaktuar për këtë vit në planin vjetor.

*Anë e fortë:*

*Zbatimi i masave disiplinore për nxënësit që mungojnë pa arsye, ushtrimi i*

*kontrollit më të shpeshtë për evidentimin e mungesave dhe informimi i shpejtë i prindërve për mungesat e nxënësve kanë efekt në ndërgjegjësimin e nxënësve në frekuencimin e rregullt të shkollës.*

*Anë të dobëta:*

*Tendencë largimi i nxënësve për arsye të tjera që nuk lidhen me shkollën.*

*Kontaktimi i prindërve për mungesat e nxënësve nuk është i menjëhershëm, informimii i mësuesve kujdestarë ka qenë i ngadaltë.*

## 2. Aspekti social

Në aspektin social në vitet e fundit gjimnazi ynë ka synuar të jetë gjithëpërfshirës, i hapur për shtresat e marginalizuara dhe për nxënësit nga kultura të ndryshme.

Prej hartës sociale të shkollës për vitin 2021-2022, hartuar nga punonjësja e shërbimit psikosocial, rezulton se rreth 2% e nxënësve (11 nxënës) vijnë nga familje me nivel shumë të ulët ekonomik, 9 nxënës ishin jetimë me një prind. 10 nxënës ose 2% e nxënësve të të gjithë shkollës vnin nga familje me prindër të divorcuar. Dy nxënës nuk jetonin në kujdestarinë e prindërve.

Një pjesë e konsiderueshme (mbi 30%) e nxënësve jetojnë në periferi të qytetit ose në zona rurale rreth tij dhe përdorin mjetet e transportit për të ardhur në shkollë.

Megjithë përpjekjet e bëra vitet e fundit për të tërhequr nxënës të komunitetit rom nga dy shkollat e afërta (Mbrostar-Ura dhe Hamil) për të vazhduar arsimin e mesëm në këtë shkollë, vetëm një nxënëse rome u regjistrua, por u largua për jashtë vendit në muajin maj 2022.

Gjatë vitit të kaluar shkollor u trajtua me mësues ndihmës 1 nxënës me AK, i cili përfundoi me sukses klasën XII.

Në fillim të vitit të kaluar shkollor, në hartën sociale të shkollës u evidentuan 37 nxënës (7% e kontingjentit) si nxënës shumë të mirë në mësim, ndërsa nxënës me probleme (që kanë vështirësi në të nxënës apo nuk ndjekin orën mësimore) u identifikuan 21 nxënës ose 4% e të gjithë nxënësve të shkollës.

Gjatë vitit shkollor 2021-2022 frekuentuan shkollën edhe dy nxënës të huaj (nga Puerto Riko, SHBA), të cilët pasi përfunduan me sukses vitin shkollor në gjimnazin tonë u larguan jashtë Shqipërisë.

Në përfundim të periudhës së parë në shkollë u rikthye nga jashtë vendit një nxënëse, e cila u regjistrua në përputhje me udhëzimet përkatëse, pas referimit nga ZVA Fier.

*Anë e fortë:*

*Nuk ka numër të lartë të kategorive problematike të nxënësve.*

*Anë e dobët:*

*Ka një nivel indiference nga prindërit e kontingjentit të nxënësve që mungojnë në shkollë dhe mungesë bashkëpunimi nga komuniteti për mbështetjen e tyre.*

### 3. Rezultatet e nxënësve

Në statistikat e përfundimit të vitit shkollor 2021-2022, treguesit e qershorit 2022, u prezantuan treguesit e mëposhtëm mbi rezultatet e nxënësve në mësimet gjatë këtij viti:

Nota mesatare e nxënësve për vitin shkollor është 7,5, ndërsa një vit më parë, në qershor 2020, ishte llogaritur në 7,42.

Kalueshmëria e nxënësve të shkollës për këtë vit shkollor (në qershor) ishte 93,8%, ndërsa në qershor 2020 ishte 99,2%.

Pas provimeve të klasës në sesionin e dytë kaluan edhe 22 nxënës, duke rritur kalueshmërinë në nivelin 98,5%.

Diferenca mes notave vjetore dhe atyre të provimeve të detyruara në sesionin e parë të MSH 2022 llogaritet në shifrën 0,33, ndërsa një vit më parë ishte 0. Por, në këto tri provime përqindja e nxënësve që rezultuan me diferencën (në vlerë absolute) më të madhe se 1 notë ishte 21,2% nga 27% një vit më parë.

*Anë e fortë:*

*Ka zvogëlim të diferencës midis vlerësimit të brendshëm me notë (nota vjetore) dhe atij të jashtëm (nota e provimeve).*

*Ka përmirësim të cilësisë së shkollës në treguesin e notës mesatare vjetore.*

*Anë e dobët:*

*Kalueshmëria e nxënësve të shkollës është më të ulët se një vit më parë.*

### 4. Treguesit për të cilët shkolla ka arritjen më të mirë dhe më të ulët në renditje për institucionet arsimore të suksesshme në nivel ZVA-je.

Këto tregues do të bëhen të ditur pasi të publikohet renditja e institucioneve arsimore në shkallë ZVA-je.

### 5. Etika dhe sjellja

Gjatë vitit shkollor 2021-2022 ka pasur ankesa për të cilat është mbledhur komisioni i etikës dhe sjelljes në shkollë. Nuk ka qenë e nevojshme marrja e masave disiplinore.

*Anë e fortë:*

*Shkolla ka një oficerë sigurie aktive gjatë kohës së funksionimit të shkollës.*

*Anë e dobët:*

*Kufizimet për shkak të pandemisë përbëjnë rrezik të shtuar për nivelin e agresivitetit nga një kontingjent nxënësish*

## **6. Arritjet në provimet kombëtare dhe në testimet kombëtare dhe ndërkombëtare.**

Në sesionin e parë në provimet e detyruara të Maturës Shtetërore 2022 u arrit një nivel kalueshmërie 96,9% sipas mënyrës së përlllogaritjes së kartës së performancës; ky tregues nuk ndryshon shumë nga ai i një viti më parë. Në provimin e gjuhës shqipe dhe letërsisë kalueshmëria ishte pak mbi 98,7% dhe nota mesatare 7,3. Në provimin e matematikës kalueshmëria ishte mbi 94% dhe nota mesatare 6,4; ndërsa në provimin e gjuhës angleze kaluan mbi 98% e nxënësve me notë mesatare 7,5. Nota mesatare e tri provimeve të detyruara në sesionin e parë të MSH 2022 ishte 7,08 ndërsa një vit më parë ishte më e ulët, 6.8.

Gjatë vitit shkollor nuk kanë qenë zhvilluar teste të tjera kombëtare ose ndërkombëtare me nxënësit e shkollës sonë.

*Anë e fortë:*

*Ka përmirësim të cilësisë së shkollës në treguesin e notës mesatare vjetore.*

*Anë e dobët:*

*Kalueshmëria e nxënësve të shkollës në provimet e Maturës Shtetërore është ende e ulët.*

## **7. Mësuesit: përqindja e orëve mësimore të munguara nga mësuesit kundrejt të gjitha orëve mësimore, numri i krediteve të punonjësve arsimorë.**

Edhe gjatë vitit shkollor 2021-2022 mungesat e mësuesve, nuk janë llogaritur për shkak të infektimit me Covid-19. Ky tregues nuk përfshihet më në treguesin e performancës së shkollës. Dy mësuese, për arsye shëndetësore, kanë qenë zëvendësuar për periudha të gjata nga mësuese zëvendësuese.

Këtë vit shkollor tre mësues të shkollës u kualifikuan për shkallën e parë (2) dhe të dytë (1), duke u vlerësuar të gjithë me rezultatin “Shumë mirë”.

*Anë e fortë:*

*Nivel i lartë i disiplinës në punë dhe angazhimit të personelit.  
Rezultate të larta në kualifikimin profesional.*

*Anë e dobët:*

*Një pjesë e personelit për arsye shëndetësore është zëvendësuar me mësues të përkohshëm.*

## **8. Pjesëmarrja në projekte me OJF, në olimpiada, konkurse, gara.**

Gjatë vitit shkollor 2021-2022 nuk ka pasur projekte me OJF, por është bashkëpunuar intensivisht me organizatën “Libera” në kuadër të programit “Engim” mbi edukimin për ligjshmërinë, si edhe organizatën “Epoka e re” në kuadër të projektit "Sporti për zhvillim-Ndërto të ardhmen".

Duke përmbushur me sukses njërin prej objektivave të planit vjetor 2021-2022, nxënësit e shkollës sonë morën pjesë denjësisht në të gjitha aktivitetet e organizuara nga Qendra e Kulturës e Bashkisë Fier, me miratimin e ZVA Fier, dhe në fazën e dytë të olimpiadave kombëtare në lëndët e biologjisë, kimisë, informatikës dhe letërsisë.

Në kampionatin e pingpongut nxënësit tanë fituan dy vende të dyta, tri vende të treta dhe dy vende të katërta. Ndërsa në fazën e dytë të olimpiadave 8 nxënës fituan të drejtën për të marrë pjesë në fazën e tretë kombëtare, në olimpiadën e biologjisë 1 nxënës u shpall fitues i vendit të dytë, në lëndën e informatikës dy nxënësit tanë morën vendin e parë dhe të dytë, në olimpiadën e kimisë një nxënës doli në vendin e tretë, në olimpiadën e letërsisë nga shkolla jonë pati një fitues të vendit të tretë dhe një fitues të vendit të katërt, ndërsa në lëndën e historisë nxënësi nga shkolla jonë ka zënë një vend të katërt. Gjithsej në aktivitetet e nivelit vendor shkolla jonë fitoi 14 vende ose çmime.

Por, suksesi më i madh ishte në fazën kombëtare të olimpiadës së biologjisë ku dy nxënësit tanë kanë zënë një vend të tretë dhe vendin e parë me maksimumin e pikëve.

*Anë e fortë:*

*Nxënësit e shkollës sonë po prezantojnë përgatitjen e tyre edhe në shkencat e natyrës.*

*Anë e dobët:*

*Ende nuk është konsoliduar puna e diferencuar me talentet nëpërmjet klubeve shkencore.*

## **9. Qëndrimi i nxënësve ndaj cilësisë së shërbimit arsimor të ofruar nga IA-ja.**

Për herë të parë pas disa vitesh ZVA Fier ka zhvilluar pyetësorë në kuadër të kartës së performancës me nxënësit, prindër dhe mësues të shkollës.

Përceptimi i nxënësve ndaj cilësisë së shërbimit arsimor të gjimnazit tonë shprehet si më poshtë:

26,5% e nxënësve shprehen se “nuk janë dakord” me pyetjet mbi cilësinë e shkollës, 8% janë “pjesërisht dakord”, 17,9% shprehen “dakord”, ndërsa pjesa më e madhe kompakte e nxënësve, 47,6% janë “plotësisht dakord” me pohimet se shkolla ofron cilësi, respektim dhe siguri për ta.

*Anë e fortë:*

*Shumica e nxënësve mendojnë pozitivisht për shkollën (65,5%).*

*Anë e dobët:*

*Ka një numër të konsiderueshëm që shprehen negativisht mbi cilësinë që ofron shkolla (26,5%).*



## SYNIMI

Synimi ynë lidhet me dy prioritetet e përcaktuara në planin afatmesëm të shkollës: “Rritja e interesit të nxënësve për shkollën, dëshmuar me nivel më të lartë të frekuentimit të orëve mësimore dhe klubeve shkollore, si edhe uljes së numrit të nxënësve që largohen drejt shkollave të tjera” dhe “ Përforcimi i imazhit të shkollës si institucion arsimor cilësor nëpërmjet arritjeve më të larta në aktivitetet konkurruese krahasuar me gjimnazet publike të ZVAP Fier dhe në rezultate më pozitive në provimet e maturës”.

Për vitin shkollor 2022-2023 synimi ynë do të jetë:

**Konsolidimi i imazhit pozitiv për shkollën tonë nëpërmjet rritjes cilësore në shumë drejtime, për t’u kthyer në shkollën ku nxënësit realizojnë ëndrrat dhe dëshirat.**

## OBJEKTIVAT

1. Në përfundimet e qershorit 2023 niveli i kalueshmërisë së shkollës të rezultojë 95% nga niveli prej 93,8% për vitin 2021-2022.

*Në këtë tregues nuk llogariten rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore*

2. Deri në fund të vitit 2022-2023 të minimizohet në nivelin 3% numri i nxënësve që përjashtohen apo largohen nga shkolla pa arsye, nga niveli prej 3,39% për vitin 2021-2022.

*Nuk llogariten transferimet e nxënësve në shkolla të tjera apo largimet e dokumentuara jashtë vendit.*

3. Në sesionin e parë të Maturës Shtetërore 2023 maturantët të arrijnë notën mesatare të provimeve të detyruara 7,2 nga niveli prej 7,08 në fund të sesionit të parë të MSH 2022.

4. Në vitin shkollor 2022-2023 nxënësit tanë të fitojnë 15 vende/çmime të vlerësuara në aktivitetet konkurruese të organizuara nga ose në bashkëpunim me ZVA Fier, nga 14 vende të fituara në vitin 2021-2022.

*Në këtë tregues përfshihen edhe vendet fituese të shpallura nga ZVA Fier në fazën e dytë të olimpiadave kombëtare.*

## VEPRIMTARITË PËR VËZHGININ E ZBATIMIT TË PLANIT VJETOR

Për vëzhgimin e zbatimit të planit gjatë gjithë vitit shkollor 2022-2023 ngarkohet një grup pune

Objektivi	Nr.	Veprimtari vëzhguese	Afati
Në përfundimet e qershorit 2023 niveli i kalueshmërisë së shkollës të rezultojë 95% nga niveli prej 93,8% për vitin 2021-2022.	1	Analizë për të përcaktuar lëndët ku ka pasur dobësi dhe mësuesit	Dhjetor 2022
	2	Hartimi i planit të posaçëm me mësuesit e lëndëve dhe kujdestarë për ndryshimin e gjendjes në pikat e dobëta të konstatuara	Janar 2023
	3	Raportim për nivelin e arritjeve të nxënësve të rrezikuar për të mbetur në klasë	Mars 2023
	4	Analizë pune e arritjeve në përmbushjen e objektivit	Prill 2023
	5	Mbledhje e posaçme e këshillimit të mësuesve për kalueshmërinë	Prill 2023
Deri në fund të vitit 2022-2023 të minimizohet në nivelin 3% numri i nxënësve që përjashtohen apo largohen nga shkolla pa arsye, nga niveli prej 3,39% për vitin 2021-2022.	1	Evidentimi i hershëm i nxënësve problematikë në ndjekjen e shkollës	Tetor 2022
	2	Analizë për çështjet e informimit të prindërve/kujdestarëve ligjorë të nxënësve të rrezikuar dhe raportimit të problematikave të reja në drejtori	Nëntor 2022, janar 2023, mars 2023

Objektivi	Nr.	Veprimtari vëzhguese	Afati
	3	Krijimi i bazës së të dhënave për ndjekjen e mësimit nga nxënësit	Nëntor 2022
	4	Mbledhje e posaçme e grupit të punës dhe këshillit të mësuesve	Tetor 2022, mars 2023
Në sesionin e parë të Maturës Shtetërore 2023 maturantët të arrijnë notën mesatare të provimeve të detyruara 7,2 nga niveli prej 7,08 në fund të sesionit të parë të MSH 2022.	1	Analizë e rezultateve të periudhave dhe diferencat me rezultatet e paratesteve që kryhen tek maturantët	Fillimi i muajit prill 2023
	2	Mbledhje e posaçme për kalueshmërinë dhe cilësinë në klasat e maturës	Fundi i muajit prill 2023
	3	Hartimi dhe zbatimi i planeve individuale të konsultimeve për nxënës që shfaqin shmangie të ndjeshme në rezultatet e vitit dhe të paratesteve	Maj 2023
	4	Analizë e rezultateve të provimeve në sesionin e parë të Maturës Shtetërore 2023	Qershor 2023
Në vitin shkollor 2022-2023 nxënësit tanë të fitojnë 15 vende/çmime të vlerësuara në aktivitetet konkurruese të organizuara nga ose në bashkëpunimim me ZVA Fier, nga 14 vende të fituara në vitin 2021-2022.	1	Evidentimi i nxënësve që kanë prirje në lëndë të caktuara të olimpiadave	Shtator-tetor 2022
	2	Hartimi dhe përshtatja e planeve të klubeve shkollore dhe orientimi drejt përgatitjes për aktivitetet konkurruese	Shtator-tetor 2022
	3	Analizë e çdo olimpiade dhe aktiviteti kulturor e sportiv konkurrues	Dhjetor 2022, janar-mars 2023

## BUXHETI

Për realizimin e objektivave të planit nuk parashikohet buxhet i veçantë.